Tirane, 22 Shtator 1937

Fort i nderuarshem im Ungj,

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: 21.05-26

Jemi mire te gjithe te shtepis dhe ju puthim doren bekimtare.

Besoj te kini marre te hollat nga Kryesia, por nuk besoj te kini mbetur i kenaqur plotesisht. Une fola per kete me z. Ilia Koten i cili me tha se kish patur bisedim dhe se Kryepiskopi do plotesoje domosdo shumen prej 1500 franga tashi dhe te tjera me von, kur te marrin te tjera. U-qqetesova edhe une se qe diten e Shtune [redacted] me ardhi me shtepi nje nga Mitropolia dhe me pyeti ne se ishit ketu juve apo kishit ikur, qe t'u jepnin te holla 300 franga. Prandaj vajta te nesermen ne z. Ilia dhe mora shpieginim. Ky me tha qe te mos behi merak, se do plotesohet shuma.

Per punen e çupes s'one Violetes, z. Papakristo me dergoi ne Ministri (esht njeri qe s'merr pergjegjesi) per te pyetur per kalimin ne klasen e trete dhe Ministria kerkon lutje (humbje kohe), dhe kuptohet qe duhet te shkoje ne kl. e dyte. Sa per burse, z. Ministri me tha se vertet dha fjalen, por si pas rregullave, d.m.th. po te marre pjese vajza ne konkursin edhe per klasen e pare (!!!), d.m.th. dolli ajo qe thosha une; s'behet gje... Mjerisht nuk e kam pare as z. Naqi, qe te shohim ne se ka mundesi per mb'at'ane

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΑΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ

apo te heqim dore nga ajo shpresë, ndonse vajzës, Viktorisë, iu-ngrit mendja për andej. Andonagji dha provim në dy mësime gëtkishin lënë për riprovim dhe dolli mirë.

Tjatër s' kam ç' t'ju shkruanj sot për sot. Jam merak gjer sa t' i vendos çupat në shkollë.

Dhiakos te fala vllazërore dhe fagit tonë përshëndoshje.

Dje isha në Xhaxha-Pandeli për një punë; ju dërgon te fala.

Ju puth dorën
me nderime
Nipi i juaj
Vasili

Mos harroni te më dërgoni sa më shpejt një fotografi te mirë për kalendarin, siç ju thashë.

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: 11 (26)

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΑΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ